

Deri te:

Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës

Në bazë të vendimit të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës nr. 13-1553/3 nga mbledhja e mbajtur më 27.12.2018, për formimin e Komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës me titull “Kontrolli kushtetues në demokracitë e reja-rasti i Kosovës”, të kandidatit Msc. Përparim Gruda, Komisioni në përbërje: Prof. Dr. Fatmire Lumani, Mentor; Prof. Dr. Mersim Maksuti, anëtar; Prof. Dr. Qebir Avziu, anëtar; Prof. Dr. Jusuf Zejneli, anëtar; Prof. Dr. Enver Hasani, anëtar, Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik i paraqet këtë:

## RAPORT

### për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës

Msc. Përparim Gruda është lindur në fshatin Polac të Komunës së Skenderajt. Shkollën fillore e mbaroi në fshatin e tij të lindjes, ndërsa atë të mesme në Skenderaj. Studimet bachelor dhe master i ka përfunduar në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, duke qenë student i shkëlqyeshëm në të dyja nivelet.

Në vitin akademik 2013-2014 ka punuar si asistent për lëndët kushtetuese dhe administrative në Kolegjin Evropian “Juridica” në Prishtinë, në vitet akademik 2014-2015; 2015-2016 si ligjërues në po të njëjtin institucion të arsimit të lartë. Gjatë viteve 2016-2017 ka punuar si Këshilltar i Jashtëm Politik i Ministrit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe si ekspert ligjor në Institutin iCHAT në Prishtinë. Nga viti 2016 punon si ligjërues dhe u.d prodekan në Fakultetin Juridik në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini”.

Deri më tani, Msc. Përparim Gruda ka botuar këto punim shkencore:

- Parliament Immunity And Building Democracy In Kosovo, Acta Universitatis Danubius. Juridica, Vol 14, No 2, 2018;

- Morali dhe Ligji: Një reflektim mbi debatin Hard-Fuller, Revista Juridica, Prishtinë, 2016;
- E drejta për një proces të rregullte ligjore në kushtetutën e Kosovës, Revista Juridica, Prishtinë, 2015;
- Konstitucionalizimi dhe kontrolli kushtetues i partive politike- rasti i Kosovës, Revista për çështje juridike dhe shoqëror E drejta, 2016;
- Disa çështja të raportit të kushtetutës së Kosovës me të drejtëndërkombëtare, Revistë për Shkencat Shoqërore Vizione, ISSN 1409-8962, 2016;
- Judicial control of administrative activity and advantages of reorganization of the juridical system in the Republic of Kosovo, Academicus, International Scientific Journal, ISSN 2079-3715, 2016;
- Kontrolli Parlamentar i Punës së Qeverisë-Rasti i Kosovës, Revista Constitutio, ISSN: 1409- 8962, 2013;
- Të Drejtat e Pakicave në Republikën e Kosovës, Revista Constitutio, ISSN: 1409- 8962, 2012.

Gjithashtu, ai është autor i librit “Ndarja e Pushteteve- analizë kushtetuese”, botuar në vitin 2015.

Në disertacionin e tij të doktoraturës me titull “Kontrolli kushtetues në demokracitë e reja-rasti i Kosovës”, trajton procesin e vendosjes së gjyqësisë kushtetuese në demokracitë e reja, rolin dhe rëndësinë e këtij instrumenti në përvpejtimin e demokratizimit të vendit si dhe efektin konkret të gjyqësisë kushtetuese në mbrojtjen e parimit të kontrollimit e balancimit të pushteteve dhe të drejtave të njeriut të përcaktuara në kushtetutë. Në të shpjegohet roli që ka pasur dhe ka gjyqësia kushtetuese në demokratizimin e vendeve.

Demokracitë e reja përballen me shumë probleme të adoptimit të standardeve të demokrative të zhvilluara, nja nga këto standarde, mbase më i rëndësishmi është instalimi i kontrollit kushtetues. Kosova është një vendi i ri me një demokraci të re e cila ka adoptuar një sistem të kontrollit kushtetues nëpërmjet gjykatës kushtetuese. Puna dhe linjat e interpretimit që ajo ka ndjekur në këto pak vite të funksionimit prodhojnë shumë material për diskutim shkencor, prandaj disertacioni ka përfokus të trajtimit Kosovën.

Sot, kontrolli kushtetues shihet si një instrument shumë i fuqishëm dhe i pazëvendësueshëm për forcimin dhe zhvillimin e demokracisë. Studimet e fundit në fushën e së drejtës kushtetuese krahasuese përcaktojnë një sërë rolesh që gjykatat kushtetuese mund të luajnë në procesin e demokratizimit të një vendi. Ndonjëherë ato janë vetë bartëse të proceseve dhe vendimeve për demokratizim e në disa raste të tjera shërbejnë si garantues të rrugës nëpër të cilën do të ndërtohet demokracia. Nuk ka asnje dyshim se gjyqësia kushtetuese në Evropë dhe më gjërë ka luajtur një rol të rëndësishëm në demokratizimin e vendeve ish-diktoriale përgjatë vijave të liberalizmit perëndimor. Kjo vlen si për vendet ish-komuniste, ashtu edhe për ato të Evropës Jugore gjatë viteve '70 të shekullit të kaluar apo për Gjermaninë dhe Italinë pas Luftës së Dytë Botërore.

Gjykatat kushtetuese arritën të bëhen akterë të rëndësishëm në proceset e rëndësishme që ndodhën në shtete dekada më radhë duke bërë madje edhe transformime të rëndësishme të botëkuptimeve të vjetruara në të mirë të mbrojtjes së të drejtave të njeriut të përcaktuara me Kushtetuta. Puna e disa prej gjykatave kushtetuese në Evropën Lindore ka treguar se pavarësisht mungesës së përvojës ato kanë arritur që të shpëtojnë nga ambicjet politike dhe të udhëhiqen nga detyrimet gjyqësore.

Përderisa kushtetuta vendos pushtetet dhe përcakton detyrat e funksionimit të institucioneve qeverisëse, ajo nuk mund të mos parashikojë dhe kontrollin mbi mënyrën e ushtrimit të këtij pushteti. Vetë kushtetutshmëria shprehet në institucionalizimin e pushtetit politik dhe nënshtimin e tij ndaj rregullave të caktuara, duke imponuar përputhjen me aktin themelor të shtetit të gjitha akteve ligjore që nxjerrin organet e pushtetit publik. Drejtësia kushtetuese ndihmon në vënien në jetë të institucionalizimit të rendit demokratik, me synim kufizimin e pushtetit dhe garantimin e respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut.

Disertacioni i doktoraturës i Msc. Përparim Gruda është i strukturuar në gjashtë kapituj:

Kapitulli i parë trajton idetë dhe praktikat e para të kontrollit kushtetues, përhapjen globale të këtij koncepti, zhvillimin e tij para Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj. Modelet e kontrollit kushtetues dhe roli i Komisionit të Vencias (KV) në zhvillimin e gjykatave kushtetuese dhe mekanizmave të tjerë të kontrollit kushtetues në Evropë janë gjithashtu objekt trajtimi në kapitullin e parë.

Në kapitullin e dytë diskutohen arsyet e adoptimit të kontrollit kushtetues nga vendet postkomuniste, kontestimi i legjimitetit të gjyqësisë kushtetuese, aktivizmi gjyqësor si nevojë veprimi në fushën e kontrollit kushtetues, aktivizmi gjyqësor si nevojë veprimi për implementimin e normave kushtetuese dhe të drejtave te njeriut. Në vijim të shpjegimit të procesit të zhvillimit të kontrollit kushtetues në vendet post-komuniste, janë analizuar problemet me ekzekutimin e vendimeve, përgjegjësia e gjyqësisë kushtetuese para kushtetutës dhe ligjt dhe ndikimi i politikës në të, si dhe arkitektura insitucionale e ndërtimit të gjykatave kushtetuese ose institucioneve të tjera të ngashme, me mandat për të interpretuar kushtetutën. Ndikimi i gjyqësisë kushtetuese në zhvillimin e demokracisë, tekalimin e tranzisionit, integrimet evropiane dhe në krijimin e standardeve ndërkombëtare lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut, kanë marrë vëmendje të konsiderueshme në këtë kapitull.

Kapitulli i tretë paraqet kapitullin bosht dhe me të rëndësishëm të studimit, në të janë analizuar në detaje, si nga aspekti teorik, doktrinar ashtu edhe nga ai praktik, i jurisprudencës, zhvillimi i kontrollit kushtetues në Kosovë dhe procesi i themelimit të GJKK. Këtu janë marrë në shqyrtim të gjitha aspektet e juridikacionit dhe palëve të autorizuara për të ngritur çështje pranë GJKK, duke i ballafaquar me argumentet dhe standarde e doktrinës bashkëkohore në fushën e së drejtës kushtetuese dhe praktikës së zhvilluar nga vetë GJKK. Gjithçka e trajtuar në këtë kapitull është shprehur në funksion të ndikimit që mund të ketë në zhvillimin e demokracisë në Kosovë. Po ashtu, ky kapitull ka marrë në shqyrtim efektin juridik dhe shkallën e zbatimit të vendimeve të

GJKK.

Në kapitullin e katërt shqyrtohet pozicioni i GJKK në kuadër të parimit të ndarjes së pushteteve. Kështu, u është dhënë përgjigje pyetjeve si: Cili është roli i GJKK në arkitekturën institucionale të ndarjes së pushteteve? Çfarë janë raportet e saj me legjislativin, ekzekutivin dhe gjyqësorin? A mund të kuptohet GJKK si një pushtet i katërt apo është një kundërpushtet? Në vijim të këtij kapitulli është argumentuar se GJKK ka për detyrim të luajë një rol thelbësor, duke fituar gradualisht të drejtën për të ushtruar një pushtet të fuqishëm dhe se funksioni kryesor është t'i u tregojë herë pas here jo vetëm ligjvënësit e ekzekutivit, por edhe gjyqësorit kufijtë kushtetuestë ushtrimit të pushtetit të tyre.

Kapitulli i pestë ka për objekt trajtimi rolin e gjykatës kushtetuese në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Aty janë analizuar dispozitat kushtetuese në lidhje me të drejtat e njeriut dhe interpretimin që gjykata iu ka bërë atyre në gjithë këto vite të funksionimit. Jurisprudanca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka zënë një vend të rëndësishëm në këtë kapitull për faktin e thjeshtë sepse interpretimet e saj janë të obligueshme për GJKK. Prandaj analizat në këtë kapitull janë fokusuar edhe në çështjet e zbatueshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese të standardeve për të drejtat e njeriut të krijuara nga Strasburgu. Gjithashtu, është analizuar edhe ankesa individuale si një institut shumë i rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Kapitulli i gjashtë dhe i fundit është titulluar “Vendimet që bënë historinë e gjykatës Kushtetuese të Kosovës”. Një titull mbase i pazakontë, por ka qenë i domosdoshëm për të kompletuar këtë studim. Është i ndarë në katër seksione: Rastet e para; Rastet e Presidentëve; Rastet Kushtetuese që dolën nga dialogu me Serbinë; E drejta për jetë; Zbatimi unik ligjor të një shteti sovran të qenit fitues në një sistem zgjedhor. Në këtë kapitull janë analizuar vendimet për të cilat ne besojmë se kanë shënuar historinë e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe kanë kornizuar identitetin kushtetues të Kosovës. Nëpërmjet tyre mund të krijohet një tablo e qartë e linjave dhe metodave të interpretimit që GJKK ka ndjekur.

Në fund të kapitujve është paraqitur një përbledhje e përfundimeve të nxjerra gjatë trajtimeve si dhe janë dhënë sugjerimet dhe rekomandimet përkatëse.

### **Përfundimi dhe Propozimi**

Disertacionit i doktoraturës me titull “Kontrolli kushtetuese në demokracitë e reja-rasti i Kosovës”, të kandidatit Msc. Përparim Gruda, paraqet një studim shumë të vlefshëm në fushën e studimeve në të drejtën kushtetuese. Në të është bërë një analizë shkencore mbi rolin e gjyqësisë kushtetuese në demokracitë e reja, zhvillimin në vendet post komuniste dhe veçanërisht për juridikcionin dhe linjat e interpretimit që ka ndjekur Gjykata Kushtetues e Kosovës gjatë këtyre pak viteve të funksionimit. Ky disertacion i doktoraturës është realizuar duke përdorur metodat bashkëkohore të studimit në shkencat juridike-kushtetuese dhe plotëson të gjitha kushtet për tu konsideruar një punime me vlerë të veçantë shkencore.

Nga i gjithë vlerësimi si më sipër, Komisioni për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës me titull “**Kontrolli kushtetuese në demokracitë e reja-rasti i Kosovës**”, të kandidatit Msc. Përparim Gruda, konstaton se ky disertacion i doktoraturës i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara dhe i propozon Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës që të aprovoj këtë raport dhe të lejoj mbrojtjen publike.

**Komisioni:**

1. Prof. Dr. Fatmire Lumani, Mentor \_\_\_\_\_;
2. Prof. Dr. Mersim Maksuti, anëtar \_\_\_\_\_;
3. Prof. Dr. Qebir Avziu, anëtar \_\_\_\_\_;
4. Prof. Dr. Jusuf Zejneli, anëtar \_\_\_\_\_;
5. Prof. Dr. Enver Hasani, anëtar \_\_\_\_\_;

